

GJAKOVA



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2026

Datë: 31.03.2026

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe nenin 21 dhe 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2022 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026, pas diskutimit lidhur me pikën 15 të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit përfundimtar Nr.01-463/01-26155 i datës 21.05.2025 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1, e miratoi këtë:

V E N D I M

Përfundimtar për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale.

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin përfundimtar për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1, ofertuesit: "4A" SH.P.K me numër identifikues 811250620 të rekomanduar nga Komisioni Vlerësues.
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale të cekur në pikën e 1 të këtij Vendimi është në kohëzgjatje prej 99 (nëntëdhjetenëntë) viteve.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të Pronës Komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është siç përcaktohet në vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër 01-011/01-14997 të datës 24.09.2024.
4. Komuna do të përfitojë nga dhënia në shfrytëzim të pronës 25% të sipërfaqes së ndërtuar bruto në ndërtimin e objektit.
5. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Rekomandimi dhe dokumentet tjera të Komisionit Vlerësues dhe oferta e përzgjedhur.

6. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës që brenda 10 ditë pune nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të lidhet kontrata me fituesin, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
7. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
8. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit .


Shefqet Shehu
Shefqet Shehu

Kryesues i Kuvendit të Komunës